



REPUBLIKA E KOSOVËS – РИПУБЛИКА КОСОВО – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 shtator 2015
Nr. ref.: VHK 838/15

VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA

në

Rastin nr. KI19/15

Parashtrues

Arif Kryeziu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së kërkesës për përfshirje në
procedurën e privatizimit**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Arif Kryeziu (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), nga fshati Sapniq, komuna e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi nuk konteston asnjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik. Ai vetëm kërkon përfshirjen e tij në listën e punëtorëve që kanë të drejtë të përfitojnë nga 20%-shi i të ardhurave nga privatizimi i NTSH "Liria" nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: NTSH "Liria").

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes ka të bëjë me *"mospërfshirje të parashtruesit në listën e punëtorëve që përfituan nga 20%-shi i të ardhurave nga privatizimi i NTSH 'Liria'", gjë që pretendohet se i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), përkatësisht me "nenin 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar], nenin 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], nenin 60 [Këshilli Konsultativ për Komunitete], nenin 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve], nenin 106 [Papajtueshmëria], nenin 117 [Imuniteti] dhe nenin 159 [Pronat dhe Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore] [Neni 159 është fshirë me amendamentin 20 të Kushtetutës]."*

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 shkurt 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 mars 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI19/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI19/15, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 26 mars 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë vendimin e fundit të cilin e konteston dhe dokumentet e tjera relevante.
8. Më 7 prill 2015, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë një deklaratë shtesë lidhur me rastin e tij, por nuk dorëzoi asnjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik.

9. Më 5 maj 2015, Gjykata, me një kërkesë të ripërsëritur, e njoftoi parashtruesin se në rast se brenda 7 (shtatë) ditësh nga pranimi i kësaj shkrese nuk dorëzon dokumentet e kërkuara, Gjykata do të vendosë rastin në bazë të dokumentacionit që ka në dispozicion.
10. Më 14 maj 2015, parashtruesi iu përgjigj shkresës së Gjykatës, mirëpo nuk dorëzoi dokumentet e kërkuara.
11. Më 8 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës ka qenë i punësuar në cilësinë e rojtarit në NTSH "Liria".
13. Më 9 tetor 2014, parashtruesi ka parashtruar një letër në Prokurorinë Publike në Prizren, të cilën e ka cilësuar si padi kundër palës së tretë. Në kërkesën e tij, parashtruesi kishte theksuar:

"[...] Vetëm pse nuk jam me kombësi shqiptare më kanë anashkaluar dhe nga privatizimi i kësaj firme nuk më kanë dhënë atë që më takon pra 20%. Vite të tëra kërkoj por jam refuzuar si nga AKP-ja [Agjencioni Kosovar i Privatizimit] po ashtu edhe nga [...] si person zyrtar në NTP- 'Liria'".

14. Gjykata nuk ka pranuar asnjë vendim që ndërlidhet me kërkesën e parashtruesit drejtuar Prokurorisë Publike në Prizren, apo ndonjë vendim tjetër që mund të jetë i lidhur me rastin e parashtruesit në përgjithësi.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 27, 41, 60, 78, 106, 117 dhe 159 të Kushtetutës.
16. Lidhur me këto pretendime, parashtruesi thekson: *"Pas privatizimit të kësaj firme Liria, mua më është cenuar e drejta njerëzore vetëm pse nuk jame Kombesi Shqiptare dhe nuk jame fut në listen e 20%, që më takon ashtu si qdo punëtor tjetër"*.
17. Në përfundim, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën si në vijim: *"Kërkoj të aprovohet lënda në favor timin dhe të gëzoj 20% që më takon"*.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë [...]”.

20. Më tutje, Gjykata i referohet dispozitave vijuese të Ligjit:

Neni 22.4 [Procedimi i kërkesave]

“4. Nëse kërkesa [...] nuk është e [...] kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të plotësuar kërkesën [...]”.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se [...] cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

21. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 29 (2) [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] dhe rregullit 32 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

*“(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:
[...]*

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.”

“(5) Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është e jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose ta qartësojë kërkesën [...]”.

22. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi ankohet në mënyrë të përgjithshme, për faktin se ai nuk ishte përfshirë në listën e punëtorëve që kanë përfituar nga 20%-shi i të ardhurave me rastin e privatizimit të NTSH “Liria”. Lidhur me këtë, ai pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 27, 41, 60, 78, 106, 117 dhe 159 të Kushtetutës.

23. Megjithatë, Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi nuk ka saktësuar dhe nuk ka dorëzuar në Gjykatë asnjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik, i cili mund t'i ketë shkelur të drejtat e lartpërmendura.
24. Gjykata, bazuar në nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe në rregullat 29 (2) (h) dhe 32 (5) të Rregullores së punës, kërkoi dy herë nga parashtruesi që të dorëzojë vendimin e fundit të kontestuar si dhe dokumentet e tjera relevante që ndërlidhen me rastin e tij.
25. Megjithatë, brenda afatit të përcaktuar, Gjykata nuk ka pranuar asnjë vendim të gjykatave të rregullta, përveç dy deklaratave shtesë të parashtruesit si dhe një aktvendim të NTSH "Liria" të vitit 1999 që kishte të bënte me punësimin e tij.
26. Duke pasur parasysh këtë që u tha më lart, Gjykata konsideron se nuk mund t'i marrë për bazë pretendimet e parashtruesit, pa saktësim të aktit konkret të ndonjë autoriteti publik, si dhe pa dokumente dhe pa prova materiale mbështetëse, ashtu siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 29 (2) (h) të Rregullores së punës.
27. Për më tepër, Gjykata thekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e kërkesës.
28. Në të vërtetë, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka treguar rast *prima facie*, në mënyrë që Gjykata të vlerësojë përmbushjen e kriterëve të tjera procedurale të pranueshmërisë, siç kërkohet me nenin 22.4 të Ligjit dhe me rregullat 29 (2) (h) dhe 32 (5) të Rregullores së punës.
29. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër dhe, si e tillë, të hiqet nga lista.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim rregullat 29 (2) dhe 32 (5) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEQË kërkesën nga lista;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arteta Rama-Hajrizi